

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-25-3033-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	LURN SH.P.K.
NUI	810084062
Adresa	Rr Ibrahim Krasniqi nr.10
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	045 510 013
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Besart Hasanaj
Adresa elektronike	lurnshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	02.03.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit	Shkodran Manaj
Adresa e plotë	Prishtine
Numri i Telefonit	044 223 969
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	sh_manaj79@hotmail.com

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritare

Me datën 05.05.2025 -Autoriteti Kontraktues publikoj Njoftimin për Kontratë ne platformën e E-prokurimit ne KRPP.Në këtë rast kemi te bëjmë me Kontratë Publike me titull: Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritareme nr prokurimi: 214-25-3033-5-1-1

Me datën 16.06.2025 -Në ora 14:00 ka qenë afati i fundit për dorezimin e tendereve/ofertave nga ana e operatorve ekonomik te interesuar .

Tenderi është zhvilluar me procedura te hapur,ku kriteri për dhënie te kontrates ka qene çmimi më i ulët. Me dt 16.06.2025 në ora 14:00-Është zhvilluar koha e hapjes së tenderëve.Gjithesejt Gjashte (6) operator kanë paraqitur ofertat e tyre per tenderin:

Ri-adaptimet e hapësirave në ndërtesat qeveritareme nr prokurimi: 214-25-3033-5-1-1

Me 27.08.2025 – Kompania LURN " SH.P.K. Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, 10000, Prishtine ,Doli njoftimi ne eprokurim: Vendimi i Ak duke na eliminuar si OE.

Pas ankeses tone ne Oshp ,ka kthyer oferten per rivleresim .

Ak me dt 10.02.2026 ka shpallur OE fitues OE tjeter duke na eliminuar prap padrejtesisht.Me 15.02.2026 kemi bere bere kerkesen per rishqyrtim ,AK na eshte pergjigjur duke refuzuar kerkesen tone si te bazuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Ak ne baze të kërkesës për rishqyrtim të bërë nga kompania jone ka marrë vendim që të refuzohet si e pa bazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 – Barazia dhe konkurrenca e lirë në prokurim (shkelje e parimit)

Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës (vlerësimi objektiv sipas kriterit të çmimit ose ofertës më të favorshme)

Neni 61 – Detyrimi për të kontrolluar oferta jo-normalisht të ulëta ose joreale Parimet e LPP-së – Efikasitet, përdorim racional i fondeve publike, transparencë dhe dokumentim të vendimmarrjes

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, paraqesim ankesë formale kundër Njoftimit për Dhënie të Kontratës në favor të operatorëve ekonomikë Hexagon Construction sh.p.k. & Eing sh.p.k., për shkak se vendimi është marrë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP) dhe parimet themelore të tij, në veçanti:

- ? parimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminimit të operatorëve ekonomikë,
- ? parimin e konkurrencës së ndershme,
- ? parimin e efikasitetit dhe ekonomicitetit në shpenzimin e fondeve publike,
- ? detyrimin për vlerësim objektiv dhe verifikim të ofertave.

1. Shkelje thelbësore në vlerësimin e ofertës fituese

Oferta e OE të shpallur fitues përmban çmime dukshëm dhe në mënyrë të pajustificueshme më të larta se çmimet reale të tregut në Kosovës, gjegjësisht çmime jo

reale në paramasë. Në shumë pozicione të dhjetëfishuara krahasuar me çmimet reale të tregut në Kosovë. Këto çmime bien ndesh me parimin e vlerësimit ekonomikisht më të favorshëm dhe dëmtojnë drejtpërdrejt buxhetin publik. Sipas vlerësimit tonë paraprak, dëmi i mundshëm financiar tejkalon 500,000.00 €.

Ky disproporcion i theksuar ndërmjet çmimit të ofruar dhe çmimeve reale të furnizimit përbëjnë rrezik serioz për dëmtim të buxhetit publik. Për këtë arsye, do të bashkëngjisim paramasën e plotë të OE fitues për verifikim të detajuar

2. Shembuj konkretë të çmimeve të ofertuara:

? A5 – Demolimi i laminatit (1 m₂): Çmimi i ofertuar: 10.00 € / m₂

Çmimi real i tregut në Kosovë për demolim të laminatit është rreth 1.00 € / m₂. Ky çmim është rreth dhjetëfish më i lartë se çmimi real i tregut dhe paraqet kosto të pajustificueshme për buxhetin publik.

A7 – Demolimi i dyerve (1 derë): Çmimi i ofertuar: 50.00 € / derë Çmimi real i tregut për demolim të derës është dukshëm më i ulët (rreth 10–15 €), prandaj ky çmim paraqet mbifaturim të pajustificueshëm.

A19 – Demolimi i tepisonit në zyra: Çmimi i ofertuar: 12.25 € / m₂ Çmimi real i tregut është rreth 1.50–2.00 € / m₂. Ky çmim është shumëfish më i lartë se realiteti i tregut.

A20 – Furnizimi dhe montimi i tepihut për dysheme teknike 50x50: Çmimi i ofertuar: 40.00 € / m₂ Çmimi real i tregut për furnizim dhe montim është rreth 15–20 € / m₂. Diferenca është e pajustificueshme dhe e dëmshme për fondet publike.

A28 – Furnizimi dhe vendosja e llajsneve të laminatit: Çmimi i ofertuar: 10.00 € / m Çmimi real i tregut për material është rreth 0.50 € / m, ndërsa me montim nuk e tejkalon 2.00 € / m. Çmimi i ofertuar është shumëfish më i lartë dhe pa bazë reale ekonomike.

A29 – Montimi i plafonit të lëshuar Armstrong: Çmimi i ofertuar: 40.00 € / m₂ Çmimi real: materiali rreth 6.00 € / m₂ dhe montimi maksimalisht 4.00 € / m₂ (gjithsej rreth 10.00 € / m₂). Oferta paraqet rritje katërfish pa asnjë justifikim teknik.

A32 – Suvatimi (1 m₂): Çmimi i ofertuar: 20.00 € / m₂ Çmimi real në treg për material cilësor është rreth 2.00 € / m₂, ndërsa puna rreth 3.00 € / m₂ (gjithsej rreth 5.00 € / m₂). Çmimi i ofertuar është katër herë më i lartë se çmimi real.

A33 – Gletimi dhe ngjyrosja: Çmimi i ofertuar: 10.00 € / m₂ Çmimi real i tregut: rreth 3.00–4.00 € / m₂. Paraqet mbifaturim të pajustificueshëm.

A34 – Vetëm ngjyrosja: Çmimi i ofertuar: 10.00 € / m₂ Çmimi real i tregut: 3.00–5.00 € / m₂. Duke pasur parasysh që në këtë projekt parashihet sipërfaqe e madhe për ngjyrosje, ky çmim i fryrë krijon dëm të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm në buxhetin e Republikës së Kosovës, duke shkelur parimin e economicitetit sipas LPP-së.

A35 – Ndarje të brendshme alumini termik me xham të lameluar 4 10 4: Çmimi i ofertuar: 225.00 € / m_l. Çmimi real i tregut në Kosovë për këtë lloj ndarjeje është maksimalisht 100.00 € / m_l, edhe duke përfshirë fitim të lartë për operatorin ekonomik. Çmimi i ofertuar është më shumë se dyfish i çmimit real.

A37 – Vendosja e dyerve të drurit: Dera 90x210 cm: 650.00 € Dyert me dimensione më të mëdha 100x210 cm dhe 200x210 cm janë ofertuar me çmime më të ulëta (425 € dhe 500 €), gjë që paraqet mospërputhje logjike dhe ekonomike. Çmimi real maksimal për një derë cilësore në treg është rreth 300.00 €. Kjo mospërputhje ngre dyshime të bazuara për njohuri paraprake mbi sasinë reale të dyerve që do të zëvendësohen, gjë që bie ndesh me parimin e konkurrencës së ndershme dhe barazisë së operatorëve ekonomikë.

A38 – Vendosja e dyerve plastike: Dera 90x210 cm: 255.00 € Ndërsa dyert me dimensione më të mëdha (100x210 cm dhe 200x210 cm) janë ofertuar me 150.00 €, çka përsëri paraqet mospërputhje të paarsyeshme ekonomike dhe të njëjtën logjikë të dyshimtë si në pozicionin A37.

B52 – Demontimi i aparatit klimatizues (12–24 BTU): Çmimi i ofertuar: 200.00 € / njësi

B53 – Montimi i aparatit klimatizues (pa furnizim): Çmimi i ofertuar: 200.00 € / njësi Në total, 400.00 € për demontim dhe montim të një klime. Çmimi real maksimal në treg për këto shërbime është rreth 80–90 €. Ky çmim paraqet mbifaturim ekstrem dhe shkelje të parimit të ekonomicitetit. C1 – Kabllo energjetike PPY 3x1.5 mm_l: Çmimi i ofertuar: 5.05 € / m Çmimi real i tregut për material cilësor është rreth 0.40 € / m, ndërsa me montim rreth 1.00 € / m. Çmimi i ofertuar është rreth pesëfish më i lartë.

C8 – Kuti për priza PVC 4M:

Çmimi i ofertuar: 10.95 € Çmimi real i tregut me montim: rreth 1.00 €.

C9 – Kuti për priza PVC 7M: Çmimi i ofertuar: 11.05 € Çmimi real i tregut me montim: rreth 1.30 €.

C13 – Kanale PVC 16x16x2000 me ngjitës: Çmimi i ofertuar: 12.00 € / 2 m Çmimi real i tregut: rreth 1.00 € / 2 m. Pozicionet C13–C18 janë në mënyrë të vazhdueshme të dhjetëfishuara. Gjithashtu, të gjitha pozicionet tjera të kablllove janë ofertuar me çmim uniform 5.05 € / m, çka nuk reflekton realitetin e tregut dhe paraqet mbifaturim të qëllimshëm krahasuar me çmimet reale në Kosovë.

Pozicionet C17–C26 janë në përgjithësi të fryra. Shembull: C17 – Prizë energjetike 230V komplet me aksesori 2M: Çmimi i ofertuar: 9.20 € Çmimi real i tregut me montim: rreth 3.00 €. Po ashtu vërehet rritje trefishe e pajustifikueshme e çmimeve për trupat ndriçues, pa asnjë arsytim teknik apo ekonomik

Duke u bazuar në faktet dhe dëshmitë e paraqitura më sipër, vlerësojmë se vendimi për dhënie të kontratës është marrë në kundërshtim me parimet themelore dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë, konkurrencës së ndershme dhe ekonomicitetit në shpenzimin e fondeve publike. Çmimet e larta dhe joreale të ofertës fituese përbëjnë rrezik serioz për dëmtim të buxhetit publik dhe tregojnë mungesë verifikimi të duhur nga Autoriteti Kontraktues dhe konsiderojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, pasi është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Gjithashtu, nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënien e kontratës, pasi është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Po ashtu, nuk është respektuar as neni 7 i LPP-së, pasi është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u shpallur fitues edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa ne jemi diskriminuar, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së përcakton qartë se Autoriteti Kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente

. Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurojnë që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, gjë që në këtë rast nuk është respektuar.

Gjithashtu, nuk është marrë në konsideratë as neni 1 i LPP-së, pasi qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike nga Autoritetet Kontraktuese në Republikën e Kosovës.

Për këto arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

- I. të Aprovojë kërkesën tonë për rishqyrtim;
- II. të Anulojë vendimin për dhënie të kontratës,
- III. të Urdhërojë rivlerësimin e ofertave në përputhje me LPP-në dhe dokumentet e tenderit, si dhe të ndërmarrë masa korrigjuese për të siguruar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes së interesit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vendimi për dhënie të kontratës i ka shkaktuar kompanisë sonë dëm financiar të drejtpërdrejtë përmes humbjes së të ardhurave dhe fitimit të pritshëm nga realizimi i kontratës, si dhe humbje të shansit real për fitimin e kontratës në kushte konkurrence të barabartë. Po ashtu, janë shkaktuar kosto të panevojshme të përgatitjes së ofertës dhe është cenuar pozita jonë konkurruese dhe reputacioni profesional në treg, duke u cenuar besimi i ligjshëm në sistemin e prokurimit publik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*